



## **MARRËVESHJE**

### **Bashkëpunimi dhe Mirëkuptimi**

*Duke patur parasysh rëndësinë dhe interesin e bashkëpunimit rajonal sindikal, duke u mbështetur në rekomandimet e Konfederatës Ndërkombëtare të Sindikatave të Lira (ICFTU), tani pas Kongresit të Vienës ITUC, se bashkëpunimi reciprok sindikal në Evropën Juglindore dhe Ballkanit Perëndimor fuqizon dhe avancoon veprimtarinë e mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve dhe lirive sindikale, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, (BSPK), Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH), dhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH), lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi dhe mirëkuptimi.*

1. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë dhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë në kuadër të bashkëpunimit rajonal sindikal bien dakort që të ndertojnë dhe realizojnë programe të përbashkëta në të gjitha fushat sindikale, me theks të veçantë zhvillimin e resurseve njerëzore, edukimin dhe trajnimin në shkollën sindikale të KSSH-së.
2. Tre Konfederatat e mesiperme bien dakort që në pajtim me kapacitetet që disponojnë paraprakisht të konsultohen edhe në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare sindikale, duke respektuar secili specifikat e sindikatës të vendit të vet.
3. Për të konkretizuar programet e përbashkëta, BSPK, KSSH dhe BSPSH u ra dakort që të shkëmbehen vizita të ndërsjellta me ekspertë të ndryshëm të fushave përkatëse, të cilat janë me interes për këto sindikata.
4. Me që Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës aktualisht nuk disponon literaturë të mjaftueshme sindikale, KSSH dhe BSPSH angazhohen që BSPK-në ta ndihmojnë në përkthimin e materialeve të ndryshme sindikale nga gjuhët e huaja në gjuhën shqipe, sipas projekteve të cilat parashohin linja buxhetore për literaturë profesionale sindikale.

5. KSSH dhe BSPSH në pajtim me kapacitetet e tyre angazhohen që BSPK-në ta përkrahin me ekspertë duke hartuar një projekt për themelimin e një shkolle sindikale në Kosovë.
6. Në mbrojtje të interesave sociale dhe ekonomike të punonjësve të Shqipërisë dhe të Kosovës për të cilat vendoset të zhvillohen protesta e manifestime masive në shenjë solidariteti përfaqësuesit e tre Konfederatave nënshkruese të kësaj Marrëveshje angazhohen të marrin pjesë në to në mënyrë simbolike duke shprehur vullnetin e mbështetjes solidare të sindikatave përkatëse.

Tiranë, me 28 Nëntor 2006

**KRYETARI I KSSH**

**Kol NIKOLLAJ**



**KRYETARI BSPK**

**Bahri SHABANI**



**KRYETARI BSPSH**

**Gezim KALAJA**

